



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:031389

Datë: 23.04.2021

Numri i dokumentit: 01725410

P.nr.1021/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN – Departamenti i pergjithshem Penal, gjyqtari i vetem gjykues Fatmir Krasniqi me sekretaren juridike Fatime Bajraktari, në lëndën penale kundër të akuzuarit **E.A.**, nga fsh., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale sulmi nga neni 187 par.1 të KP-së, sipas aktakuzes së Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.3176-8/2016 të datës 26.06.2018, pas mbajtjes së seancës fillestare gjyqesore publike, në prezencën e Prokurorit Themelore të shtetit në Prizren Merita Gaka, të akuzuarit, me datë **07.04.2021**, mori dhe shpalli publikisht këtë:

AKT GJYKIM

I akuzuari **E.A.**, nga i ati, e ëma, e vajzërisë, i lindur më datënë Prizren, tani me banim në fsh., Komuna e Prizrenit, i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, punëtor fasader, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 09.07.2016 rreth orës 13,20 min, saksyesisht në parkun e qytetit, i pandehuri **E.A.**, me qëllim të sulmit fizikisht të demtuarin **J.G.**, në atë mënyrë që deri sa i demtuari ishte duke qendruar në parkun me bashkshorten e tij, i pandehuri për shkak të mosmarreveshjeve të mehereshme që kishte me të demtuarin, fillimisht fjaloset me të, me pas me boks të hekurit e godet në pjesë të ndryshme të trupit, të cilin mjet i demtuari, arrin t'ia marrë nga dora e të pandehurit, mirepo i demtuari si pasojë e këtyre veprimeve të të pandehurit, nuk peshon lëndime trupore.

-kësodore kryen veprën penale të sulmit nga neni 187 par.1 të KP-së.

Gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 46, 73, 74, 75e 76 të KP-se, dhe neni 187 par.1 të KP-se, si dhe neni 365 të KPP-se, të akuzuarit i shqipton:

D E N I M E G J O B E

Ne lartesi prej **150.00 /njeqindepesedhjte/ Euro** te cilen shume te denimit i akuzuari eshte i obliguar te paguaj ne afat prej 15 diteve, pas plotefuqishmerise te ketij aktgjykimi, nese denimi me gjobe nuk ekzekutohet as me detyrim i njeiti do te zevendesohet me denim burgu duke llogaritur per çdo 20 Euro nje dite burg, rrespektivisht 7 dite burgim.

Te akuzuarit gjykata krahas denimit kryesor i shqipton edhe denimin plotesues dhe atr marrjen-konfiskimin e nje boksi te hekurt me ngjyre te zeze, si mjet i kryerjes se vepres penale,

Ne kuptim te nenit 59 e 69 te KP-se

I akuzuari obligohet qe do ti paguaj te gjitha shpenzimet te procedures penale, ne emer te shpenzimeve te paushalit gjyqesor shumen prej **30,00 euro, si dhe ne emer te kompenzimit per viktimat e krimit shumen prej 30,00 euro**, te gjitha keto ne afat prej 15 diteve, pas plotefuqishmeris se ketij aktgjykimi.

I demtuari J.G., nga Prizreni rr., nr... per realizimin e kerkeses pasurore-juridike, udhezohet ne kontest te rregullt civilo-juridik.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Prizren, kesaj gjykate i ka parashtruar aktakuzen me PP. nr.3176-8/16 te dt.26.06.2018, kunder te akuzuarit E.A., nga fsh....., Komuna e Prizrenit, per shkak te vepres penale sulmi nga neni 187 par.1 te KP-es.

Gjykata ne shqyrtim kryesor ka vertetuar gjendjen e ketille faktike nga pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit i cili vullnetarisht e ka pranuar fajesin, per shkak te se ciles gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyres zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonje prove e pa pranueshme, gjithashtu gjykata ne teresi ka vertetuar se i akuzuari ka kuptuar natyren dhe pasojat e pranimit te fajesise per vepren penale e cila i vihet ne bare, e qe pranimi i fajesise eshte bere ne menyre vullnetare dhe pa kushtezime, duke u mbeshtetur ne fakte dhe prova materiale te cilat jane paraqitur ne aktakuze, per te cilat i akuzuari ka qene i njoftuar me te gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur ne perfundim, se pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit eshte bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-se, dhe faktet qe permban aktakuza, ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e vepres penale te sulmit nga neni 187 par.1 te KP-se, dhe per kete gjykata te akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi denimin me gjobe si te merituar, paraprakisht duke e vertetuar pergjegjesine e tije penalo-juridike.

Me rastin e caktimit te denimit ndaj te akuzuarit gjykata vleresoi te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 73 te KPK-se te cilat ndikojne ne llojin dhe lartesine e denimit, duke mos e gjetur rrethanat posaqerisht renduese, e si rrethane lehtesuese eshte marre pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes se vepres penale, pendimi i thelle i tije, me pare i pagjykuar, çka nenkupton se nuk ka ardhur ndesh me rregullat pozitive ne kuptim te dispozitave te nenit 74, 75, e 76 gjykata morri per baze edhe faktin qe i akuzuari ka bashkepunuar me gjykatën, bashkepunimi i tije ka qene vullnetar ne hetimin dhe ndjekjen penale, ka pranuar fajesin dhe ka shprehur keqardhje per vepren e kryer penale dhe poashtu edhe publikisht i kerkon falje te demtuarit, dhe deshiron ta gjeje gjuhen e pajtimit dhe te mirekuptimit, veprimi ka qene i rastit-momentit, ka pasur sjellje korrekte para gjykates, i

premtion gjykates se ne te ardhmen nuk do te perserise vepra te ketilla penale, andaj gjykata i shqiptoi denimin me gjobe sepse konsideron se me me kete mase sanksionuese do te arrihet qellimi i denimit, duke menduar se denimi i shqiptuar i pergjigjet shkalles se pergjegjesise se tije dhe me kete denim do te arrihet qellimi i denimit e risocializimit te te akuzuarit, qe i njejti ne te ardhmen te jete i kujdesshem dhe do te permbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi paushallin gjyqesor gjykata e bazoi ne kuptim te nenit 453 te KPPK-se.

Si u cek edhe më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

P.nr. 1021/2018 të datës 07.04.2021

**Sekretare Juridike
Fatime Bajraktari**

**Gjyqtari
Fatmir Krasniqi**

UDHËZIM JURIDIK: Kunder ketij aktgjykimi pala e pakenaqur ka te drejte ankese ne afat prej 15 diteve nga dita e marrjes se te njejtës, Gjykates se Apelit ne Prishtine nepermjet te kesaj gjykate.